

STATUTI

Per krijimin e Shoqerise

„Rail Conception” sh.p.k

§ 1 Firma dhe Selia e Shoqerise, Viti tregtar

1. Shoqeria quhet „Rail Conception” sh. p. k.
2. Selia e Shoqerise „Rail Conception” sh. p.k. do te jete ne Tirane, Shqiperi, ne adresen: Rr. K. Karafili, P. 14, Hyrja 24, Ap. 14 Tirane.
3. Si vit financiar i shoqerise quhet viti kalendarik.

§ 2 Objekti i shoqerise

1. Objekti i shoqerise „Rail Conception” sh.p.k eshte:
 - aktiviteti tregtar me materiale ndertimi per hekurudha, sikunder jane shina, materiale ndertimi prej betoni ose druri te te gjitha llojeve;
 - konsulenca ne fushen e ndertimit te hekurudhave
 - ofrimi i sherbimit dhe servisit ne te gjitha llojet dhe menytrat ne fushen e hekurudhave perfshire vendosjen e linjave dhe zbatimin e teknologjive te reja dhe bashkekohore.
2. Shoqeria „Rail Conception” sh.p. k mund te ushtroje te gjitha aktivitetet, te cilat ne menyre direkte ose indirekte i sherbejne qellimit te shoqerise. Shoqeria „Rail Conception sh.p. k” mund te krijojë dege te sajat, ndermarje te tjera ose te ngjashme me te, te perfitoje te tilla ose te marre pjese ne ndermarje te tjera tregtare ne format e ndermarjeve te perbashketa ose J-Venture.

§ 3 Kapitali shoqerise dhe pjeset ne kapltal

1. Kapitali i shoqerise „Rail Conception” sh.p.k perbehet nga shuma prej 100 000 Lek.

2. Kapitali i shoqërisë ndahet në dy pjesë:
 - a) Z. Wolfgang Schell ka 1 kuotë 50% dmth. 50 000 Lekë ;
 - b) Z. Stefan Zimpelmann ka 1 kuotë 50% dmth. 50 000 Lekë;
3. Kapitali i shoqërisë do të paguhet në Lek, në kohën e krijimit të shoqërisë.

§ 4 Drejtimi i shoqërisë dhe përfaqësimi

1. Shoqëria "Rail Conception" sh. p. k ka një ose disa administratorë. Nëse është emëruar vetëm një administrator, atëherë ky e përfaqëson i vetëm shoqërinë. Asambleja e ortakëve mund ti autorizojë të gjithë administratorve bashkarisht ose secilit prej tyre kompetenca individuale të përfaqësimit.
2. Administratori kryen veprimet e administrimit dhe ushtron të gjitha kompetencat në interes dhe në emër të shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, me përjashtim të atyre që ligji dhe ky Statut ia jep shprehimisht Mbledhjes së ortakëve.
3. Administratori është individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë apo të tretëve, për veprime të kryera në shkelje të ligjeve ose që bien në kundërshtim me këtë Statut dhe përgjigjet për dëmin e shkaktuar me faj.
4. Administrator i shoqërisë caktohet

Z. Wolfgang Schell.

Me një afat prej 5 vjetësh.

§ 5 Asambleja Shoqërisë, shkurtimi i afatit të njoftimit për shkak të rëndësishëm.

1. Asambleja e Shoqërisë thëritet vetëm nëse kjo është në interes të Shoqërisë dhe së paku një herë në vit. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Shoqërisë për miratimin e bilancit vjetor dhe përdorimin e fitimit duhet të thëritet brenda 7 muajve të parë të vitit financiar të shoqërisë.
2. Thirja e Asamblesë së Ortakëve është e drejtë e çdo Administratori të Shoqërisë. Edhe thirja nga vetëm një administrator është e mjaftueshme. Një

Ortak, pjesa e kapitalit të së cilit përbën 1/10 e kapitalit të shoqërisë, ka të drejtë të thërasë mbledhjen e Asamblesë por me klausolën e parashtrimit të qëllimit dhe arsyes së thirjes. Nëse nuk përmbushet kërkesa e tij, atëherë ai ka të drejtë të thërasë vetë mbledhjen duke ju përmbajtur normave të kësaj kontrate dhe duke njoftuar arsyen e mbledhjes.

3. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve duhet ti bëhet secilit Ortak me shkrim. Njoftimi së bashku me rendin e ditës duhet ti dërgohet secilit Ortak brenda një afati 2 javor në adresën e tij të fundit. Për efekt vlefshmërie të afatit të njoftimit, konsiderohet si fillim afati data e vulës së Postës; dita e njoftimit dhe data e mbledhjes nuk përfshihen në afatin e njoftimit. Si vend i mbledhjes quhet selia e shoqërisë, sa kohë që të gjithë ortakët nuk kanë përcaktuar një vend tjetër. Ortakët kanë të drejtë të shmangen nga respektimi i këtij formaliteti. Si përjashtim, afati i njoftimit mund të shkurtohet në një javë, por vetëm atëherë kur një shkak i rëndësishëm nuk lejon zbatimin e afatit të zakonshëm, i cili do të ishte i papranueshëm për shoqërinë. Kjo arsye duhet të bëhet e njohur në ftesën për mbledhje.
4. Secili ortak mund të përfaqësohet në asamblenë e ortakëve nëpërmjet një ortaku tjetër ose një Avokati ose Eksperti kontabël apo profesionisti, i cili i nënshtrohet detyrimit të heshtjes. Me kërkesën e një pjesëmarësi në mbledhje mund të paraqitet si provë edhe prokura përkatëse, e cila duhet të jetë me shkrim.
5. Nëse për protokollin e mbledhjes së asamblesë nuk kërkohet forma noteriale, atëherë protokollin duhet të përmbajë vendin dhe datën e mbledhjes, pjesëmarësit, rendin e ditës, pikat kryesore të diskutimit si dhe vendimet e marra në mbledhje. Ai duhet të nënshkruhet nga drejtuesi i mbledhjes së asamblesë dhe kopja ti dërgohet çdo ortaku.
6. Ortaku, i cili ka moshën më të madhe, drejton mbledhjen e parë të asamblesë. Më pas me vullnetin e gjithë ortakëve drejtimin mund ta marrë një tjetër ortak.

§ 6 Vendimet e Asamblesë.

1. Vendimet merren me shumicën e votave të dhëna në mbledhjen e asamblesë, sa kohë që në këtë kontratë ose në ligj nuk parashihet ndryshe. Çdo 150 Lek në kapitalin e shoqërisë përbën një votë. Refuzimi i votimit konsiderohet jo si votë e dhënë. Barazia në votim konsiderohet si refuzim i kërkesës.
2. Çdo ortak ka vetëm një votë pavarësisht nga pjesa e tij në kapitalin e shoqërisë. Cënimi i këtij parimi çon në pavlefshmërinë e votave të dhëna. Votimi si përfaqësues i një shoqërie tjetër për pjesën e kapitalit të tij mbetet i pandryshuar.
3. Asambleja është e aftë të marrë vendime vetëm nëse ajo është thërritur në mënyrë të rregullt, ortakët janë të pranishëm ose të përfaqësuar dhe votojnë së paku 51% e ortakëve me të drejtë vote. Në votim numërohen edhe Ortakët, të cilët sigurojnë pjesëmarrjen e tyre nëpërmjet telefonit, ose videokonferencës ose me çdo formë a mënyrë tjetër të barazuar me këto dhe të gjithëpranuar.
4. Vendimet e asamblesë merren me pëlqimin e gjithë ortakëve të shoqërisë, në të gjitha rrugët e komunikimit (me shkrim, me postë ose me gojë, a me telefon) sa kohë që të gjitha ortakët e shoqërisë japin pëlqimin e tyre dhe marrin pjesë në marrjen e votimit ose në ligj a kontratë nuk parashihet ndryshe; menjëherë pas marrjes së vendimit duhet të hartohet një protokoll, i cili i paraqitet të gjithë ortakëve.
5. Padia e pavlefshmërisë mund të ngrihet brenda 6 javësh nga data e marrjes së vendimit.
6. Secili ortak në marrëdhënie me të tretët, i nënshtrohet detyrimit të heshtjes për çështje që lidhet me shoqërinë, përfshirë edhe përmbajtjen, rendin e ditës dhe vijueshmërinë e mbledhjes së asamblesë së ortakëve.

§ 7 Bilanci vjetor

1. Bilanci vjetor i shoqërisë hartohet sipas metodikës së parashikuar në ligj dhe miratohet me vendim të asamblesë së ortakëve.

§ 8 Disponimi mbi pjesët e kapitalit.

1. Vlefshmëria e kalimit të pjesës së kapitalit të një ortaku, ose edhe e një pjesë të saj, ose çdo disponim tjetër i saj kërkon një vendim të mëparshëm të Asamblesë së ortakëve. Ortaku përfitues ka të drejtë vote.
2. Ortaku, i cili dëshiron të shesë plotësisht ose pjesërisht pjesën e tij në kapitalin e shoqërisë, duhet që fillimisht tja ofrojë atë ortakëve të tjerë të shoqërisë, nëpërmjet njoftimit me shkrim për secilin ortak. Ai duhet ti bëjë të njohura edhe çmimin dhe kushtet e tjera të shitjes. Ortaku duhet të deklarojë pranimin e tij brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ofertës.
3. Secili ortak gëzon të drejtën e parablerjes në rastin e shitjes së pjesës së kapitalit të një ortaku ose një pjese të saj. Ortaku shitës duhet ti paraqesë Ortakëve të tjerë menjëherë kontratën e lidhur me përfituesin e pjesës. E drejta e parablerjes mund të ushtrohet kundrejt blerësit brenda një afati prej 6 javësh nga njoftimi i kontratës.
4. Të gjitha normat e kësaj kontrate lidhur me kalimin e pjesëve të kapitalit janë të vlefshme për të gjitha veprimet e tjera juridike, që për nga pasojat e tyre barazohen me kalimin dhe transferimin e pronës.

§ 9 Trashëgimia në pjesët e kapitalit

1. Në rast të vdekjes së një ortaku, pjesa e tij trashëgohet nga ortakët e tjerë të shoqërisë. Në këtë rast shoqëria vazhdon me ortakët e tjerë duke u përjashtuar të gjithë ata që nuk kanë të drejtë të trashëgojnë. E drejta e tyre e kompensimit zbatohet sipas §12 të këtij Statuti.
2. Nëse për shkak të testamentit thëriten në trashëgimi persona të tjerë, nga ato të përmendur në paragrafin 1, ortakët e mbetur të shoqërisë kanë të drejtë të vendosin që trashëgimia ti kalojë plotësisht ose pjesërisht vetë shoqërisë, ose një apo disa ortakëve të saj ose një të treti.
3. Rregullimi i paraparë në paragrafin 2 vlen përkatësisht edhe kur trashëgimtar është një bashkësi, në të cilën në një farë mënyre mer pjesë një person, i cili nuk i përket rrethit të trashëgimtarëve të përcaktuar në paragrafin 1. Trashëgimtarët janë të detyruar të përfaqësohen bashkërisht nga një person i cili i nënshtrohet detyrimit të heshtjes. Të drejtat në shoqëri të trashëgimtarëve pezullohen sa kohë që nuk është caktuar përfaqësuesi i tyre.

4. Sa kohë që nuk është kryer kalimi ose transferimi, nuk llogaritet kjo pjesë në proces votimi.
5. Normat e § 10 pikat 3 - 5 të këtij statuti veprojnë për rastin e kalimit. E drejta e kompensimit për trashëgimtarët që nuk marrin pjesë në trashëgim të pjesës së kapitalit të shoqërisë përcaktohet sipas § 12.
6. Çdo ortak duhet të tregojë respekt dhe të tregojë kujdes që në rastin e hartimit të testamentit ti përgjigjet qëllimit dhe frymës së kësaj norme.

§ 10 Përthithja e pjesëve të kapitalit.

1. Me vendim të ortakëve, pjesë të veta të kapitalit të shoqërisë ose pjesë kapitali të ortakut apo pjesë të tyre mund të përthithen nga shoqëria me vullnetin e tyre.
2. Pa vullnetin e ortakut përkatës, pjesa e tij në kapitalin e shoqërisë mund të tërhiqet-pa cënuar normat e tjera të kësaj kontrate- nëse:
 - a. Pjesa e tij i është nënshtruar një mase ekzekutimi, pengu ose sekuestre, e cila nuk është hequr brenda një afati prej 2 mujor;
 - b. kur mbi pasurinë e ortakut përkatës është hapur një procedurë likuidimi ose nje procedurë tjetër, e cila për nga psojat është e njejtë me të ose hapja e saj për shkak të mungesës së masës është refuzuar;
 - c) ka një arsye të rëndësishme, që lidhet me vetë ortakun e cila ligjëron përjashtimin e tij nga shoqëria;
 - d) vetë ortaku ngre një padi për largim nga shoqëria ose kur për arsye personale kërkon të largohet nga shoqëria.
3. Kur pjesa e kapitalit i përket bashkarisht disa zotëruesve në bashkëpronësi në tërësi ose në pjesë, mund të përthithet nga shoqëria nëse kjo gjen zbatim qoftë edhe për njerin prej tyre.
4. Marja e pjesës së kapitalit nga shoqëria pason nëpërmjet një deklarate të administratorit mbi bazën e vendimit të Ortakëve. Në vend të përthithjes, ortakët mund të vendosin që ortaku përkatës tja kalojë vetë shoqërisë pjesën e tij në kapitalin e saj ose tja kalojë njërit ose disa persona të përcaktuar prej

tij. Në zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2 ortakut përkatës nuk i njihet asnjë e drejtë vote.

5. Në momentin e njoftimit të vendimit për përthithjen e kapitalit, ortakut përkatës quhet i larguar nga shoqëria.

§ 11 Shpërblimi për tërheqjen e kapitalit.

1. Shoqëria detyrohet të paguajë një dëmshpërblim në rastin e përthithjes së kapitalit. Shpërblimi i përgjigjet vlerës së regjistruar të kapitalit, e cila rezulton nga mbyllja e bilancit tregtar të vitit të fundit financiar të shoqërisë. Shpërblimi do të përfshijë edhe shumat, që shoqëria i ka shpërndarë ortakut përkatës, që prej ditës së hartimit të bilancit si pjesë fitimi.
2. Ortakut të cilit i merret pjesa e tij kapitale nuk ka të drejtë për pretendime të tjera.
3. Përcaktimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 janë të vlefshme edhe kur pjesa kapitale transferohet tek shoqëria ose të tretët sipas § 10 germa 4.
4. Në rast të mosmarrëveshjes së palëve mbi shumën e dëmshpërblimit, thëritet një ekspert kontabël i pavarur si arbitër, i cili vendos duke respektuar normat e këtij statuti. Vendimi i tij është i detyrueshëm për palët. Nëse palët nuk japin pëlqimin e tyre mbi një person të tillë, atëherë ky caktohet nga dhoma e ekspertëve kontabël.
6. Me vendim të ortakëve, shpërblimi paguhet gjer në pesë këste të barabarta vjetore, për aq kohë sa kjo është e nevojshme prej gjendjes së shoqërisë. Ortaku përkatës nuk ka të drejtën e votës. Pagesa fillon 6 muaj pas miratimit të shumës së shpërblimit.
7. Bilanci përkatës i shpërblimit duhet të bëhet me një pagesë interesi në shumën prej 4% në vit. Interesat paguhet me këstet përkatëse. Një shlyerje e parakohshme – edhe e shumave të pjeshme – është e lejueshme.

§ 12 Kompensimi për raste të tjera.

1. Në rastet e largimit të një ortaku nga shoqëria, këtij i lind e drejta e përfitimit të vlerës të pjesëmarjes së tij në shoqëri; kjo vlen pa cënuar përmbajtjen e §§ 9 dhe 10 edhe për tërheqjen e parashikuar në § 9 germa 2, 3 dhe § 10 germa 2d, si dhe § 15 germa 4. Masa e shumës caktohet sipas metodës së rekomanduar nga dhoma e ekspertëve kontabël.
2. Përmbajtja e § 11 germa 4 - 6 vlejnë edhe për këtë rast.
3. Në rastet, në të cilat shpërblimi i bërë në rastin e përthithjes sipas § 10 të këtij statuti i përgjigjet vlerës së bilancit, ortaku merr si shpërblim vetëm atë vlerë që duhet të paguhet në rast se nuk do të ndodhte përthithja, por do të zbatohet largimi në mënyrë tjetër.

§ 13 Marrëdhëniet ndërmjet ortakëve.

1. Përveç ndarjes së rregullt të fitimit, shoqëria nuk ka të drejtë të krijojë asnjë ortaku ose pjestarëve të tij përfitime pasurore, që rrjedhin nga marrëdhëniet e shoqërisë.

§ 14 Ndalimi i konkurrencës.

1. Ortakët dhe administratori i shoqërisë me vendim të asamblesë së ortakëve mund të përjashtohen nga ndalimi i konkurrencës.
2. Personi përkatës përjashtohet nga e drejta e votës. Asnjë ortak ose administrator i shoqërisë mgjth. nuk lejohet të veprojë në kundërshtim me interesat e shoqërisë ose të çënojë ato.

§ 15 Kohëzgjatja e shoqërisë dhe zgjidhja kontratës.

1. Shoqëria vepron pa afat.
2. Secili ortak mund të largohet nga shoqëria, duke i paraqitur asaj një deklaratë të largimit në një afat prej 24 muaj para fundit të vitit, por jo më parë se 31.12.2022. Deklarata duhet të jetë me shkrim. Sa kohë që nuk parashikohet ndryshe, shoqëria nuk priset me rastin e largimit. Ortaku përkatës largohet vetëm në fund të vitit.
3. Nëse një ortak largohet nga shoqëria, ortaku tjetër ka të drejtë që nëpërmjet një kërkesë me shkrim kundrejt të larguarit, të kërkojë të marrë pjesën e tij. E

drejta e kalimit mund të ushtrohet brenda 6 muajsh nga data e marrjes së kërkesës prej të larguarit.

4. Ortakët e mbetur të shoqërisë në një rast të tillë mund të vendosin që pjesa përkatëse e kapitalit të shoqërisë ti kalojë vetë shoqërisë, njerit ose disa ortakëve, ose një të treti ose së fundi të përthithet. Ortaku i larguar nuk ka të drejtë vote.

§ 16 Marrëveshjet pasurore.

1. Ortakët e martuar janë të detyruar, të realizojnë një marrëveshje të pasurisë martesore, e cila i përgjigjet normave të mëposhtëme. Për më tej ortakët e martuar janë të detyruar që të hynë në shoqëri vetëm me paraqitjen e marrëveshjes.
2. Ortakët e martuar janë të detyruar që nëpërmjet një kontrate martesore noteriale të përcaktojnë rregjimin e tyre pasuror, ndarjen e pasurisë si dhe mënyrën e ndarjes së fitimit.

§ 17 Dispozita të fundit

1. Çdo marrëveshje ose shtesë për këtë statut kërkon formën me shkrim. Nëse norma të veçanta të kësaj kontrate janë të pavlefshme ose krijojnë boshllëqe apo interpretim nuk preket vlefshmëria e normave të tjera të statutit. Ortakët detyrohen të vendosin në vend të saj një normë tjetër, e cila i përgjigjet vullnetit të palëve të shprehur në këtë kontratë, qëllimit të tyre dhe frymës efektive të kontratës dhe qëllimit të shoqërisë.
2. Shpenzimet për krijimin e shoqërisë mbulojnë prej saj.
3. Kontrata formulohet në gjuhën shqipe, por për efekt të zbatimit dhe interpretimit, palët detyrohen ti referohen për çdo rast tekstit origjinal në gjuhën gjermane.

Tiranë 16.03.2018

Ortakët e Shoqërisë „**Rail Conception sh.p.k**“

Wolfgang Schell

Stefan Zimpelmann

